



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion
Mbledhja nr. 31/2010
Prishtinë, 14. 09. 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport
dhe Telekomunikacion**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare, Ethem Çeku, Fatmir Rexhepi, Mursel Haljilji, Sala Berisha – Shala, Kaqusha Jashari, Adem Salihaj dhe Műfera Şinik.

Munguan: Adem Grabovci, Qamile Morina dhe Zef Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: Simon Uzunov dhe Dirk Buschle – Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Nicholas Towle, Celia Whitaker; Kendrick Wentzel – Deloitte, Arben Nagavci, Fred Guymont; Bill Klawonn – USAID, dhe Ibrahim Krasniqi konsulent.

Stafi mbështetës: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Myzejene Selmani, kryetare.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t e

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të 22. 07. 2010;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-184 për Energjinë;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të 22. 07. 2010

Procesverbali i mbledhjes së 22. 09. 2010 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.03/L-184 për Energjinë;

Kryetarja – Fillimisht përshëndeti te pranishmit nga delegacioni Sekretariatit te Komunitetit te Energjisë dhe USAID-it dhe falënderoj për ardhjen, për mundësin këmbimit te përvojave dhe mundësin mbështetjes se komisionit parlamentar. Pastaj i dha fjalën te pranishmëve në takim, për te njoftuar komisionin me komentet dhe rekomandimet lidhur për pakon Projektligjeve për Energjinë.

Dirk Buschle (Sekretariati i Komunitetit te Energjisë – SKE) – bëri një prezantim dhe një hyrje mbi punën Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (në vijim SKE), dhe qëllimi kryesor i këtij prezantimi është që të behet një përshkrim mbi Traktatin e Energjisë në nivel të përgjithshëm, dhe pastaj më hollësishme pyetjet specifike që kanë deputetet. Ne vija te përgjithshme e shpjegoj Komunitetin e Energjisë. Tha që ky është një Traktati multilateral dhe funksionin në baze te nënshkruesve te marrëveshjes që janë shtetet. Ne Traktatin për Komunitetin te Energjisë janë rregullat të detyrueshme që ka të bëjmë me tregun ne fushën energjisë, dhe këto rregulla ligjore janë te Bashkimit Evropian. Ne fakt Komuniteti i Energjisë ka të bëjë me legjislacioni e Bashkimit Evropian. Pra dhe vendet që janë nënshkruese te këtij traktati janë të obliguar t'i zbatojnë këto rregulla ne legjislacioni e brendshme. Kjo ka të bëjë më Parlamentet ne mënyrë te drejtpërdrejtë. Traktati i Komunitetit te Energjisë i ka pranuar disa rregulla për konkurrencën, ne modelin e tregut. Shteti nuk mund ta çrregulloj një tragë të brendshme përmes subvencionimit. Tha që ne e kemi një bord rregullator ku aty përfaqësohet ZRRE-ja, me sekretarin dhe institucionin tonë, ku i mbikëqyrim dhe punojmë në bazë te legjislacionit të BE-së te gjitha palët nënshkrues te traktatit.

Simon Uzunov (Sekretariati i Komunitetit te Energjisë – SKE) - tha që do t'i përmbledh disa parime kryesore te funksionimit që definohet korniza ligjore. Në kuadër të Traktatit ekzistojnë tri pako të akteve ligjore të cilat duhet të meren parasysh, ekziston traktati i cili detyron legjislacionin evropian e cila vije së bashku me nënshkrimin e traktatit me të gjitha palët kontaktuese në vitin 2006-të; është korniza ligjore e elektricitetit, gazit natyror, ambientit, që ka të bëjë vetëm me energji për konkurrencën e

cila është substanciale për zhvillimin e tregjeve energjetike dhe për energjinë e ri përtritshme, këto janë fusha kryesore të cilat janë inkuadruar në tregjet energjetike të cilat janë duke u zhvilluar dhe integruar nëpër tërë legjislacionin e komitetit të energjisë. Disa akte ligjore janë drejtuar nga këshilli ministror nga sigurimi dhe furnizimi për energji në veçanti të efikasitetit të energjisë e cila ka qenë në vitin 2009-të një pako e energjisë e cila ka të bëjë me efikasitetin e energjisë i tërë ky legjislacion që duhet të merret parasysh kur vlerësohet përmbushja e akteve nënligjor në mënyrë të rregullt. Dhe i raportojmë në mënyrë të rregullt tek Këshilli ministror kjo është një detyrë kryesore e sekretariatit. Përpos kësaj ekziston edhe grupi i tretë i akteve nënligjore të cilat janë diskutuar si të bëhet vendimi i këshillit ministror që është direktiva e re nga viti 2009-të që është shumë e rëndësishme për politikën e Unionit Evropian dhe gjithashtu për burimi energjetike të ripërtritshme në rajon. Gjithashtu ekziston një pako e legjislacionit për naftë dhe shfrytëzimi i këtij burimi, dhe legjislacioni për pakon e tretë të energjisë kjo do të diskutohet menjëherë pasi që Këshilli të merr vendim. Ku duhet të merret parasysh komuniteti i energjisë duhet ta implementoj sekretariati, monitorimin e implementimin të kësaj pakoje energjetike sa i përket kësaj pakoje të tretë për matësit elektrik, mbështetësit e legjislacionit ekzistues, konsideron se legjislacioni është implementuar, dhe është sjellë në përputhshmëri dhe ekziston mundësia të shkohet më tutje. Theksoj së pari duhet të hartohen parakushtet para se të përmbushet diçka në detaje ku shkurtimisht do të zbatohet. Dhe të shikohet se cila është korniza bazë lidhur me sektorin e energjisë, duke i diskutuar tri akte ligjore të cilat janë tani mandatorë, direktivat 2003/54 për tregjet e energjisë, rregullorja për alokimin në mese kufijve dhe menaxhimin e kongjestionëve dhe direktiva e cila e siguron direktivat e energjisë. Tha se njëra nga direktivat më të rëndësishme është shërbimi i publike dhe mbrojtja e konsumatorëve. Keto tri projektligje që janë në shqyrtim janë obligimet e kompanive për shërbimet publike të cilat duhen të jenë funksionale.

Ethem Çeku – tha se Komisioni është duke amendamentuar ligjet për Energjinë, kanë kaluar leximin e parë në Kuvend, dhe ne kemi pritur edhe rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit për Energji për të kompletuar sa më mirë ligjet për Energjinë. Në vizionin zhvillimor të vendit vital ka qenë sektori i energjisë dhe minierave dhe është shumë e rëndësishme ta zhvillojmë sektorin e energjisë? Si ta ruajmë konkurrencën në sektorin e energjisë? Çfarë duhet të ndërmarrim që të zhvillojmë tregjet në fushën e energjisë? Si ta bëjmë forcimin dhe funksionalizimin më të madh të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë? Gjithashtu në fund ceku zoti Çeku se në sektorin e energjisë është shumë me rëndësi qështja e transparencës.

Fatmir Rexhepi - pyeti se cili është sugjerimi i Sekretariatit të Komunitetit për Energji për Kornizën ligjore të Energjisë dhe Strategjinë e Energjisë në Kosovë? Dhe cilat janë përparmit dhe mangësitë e monopolit dhe të konkurrencës në fushën e energjisë?

Adem Salihaj – theksoi se ne në Kosovë kemi monopol në sektorin e energjisë dhe nuk ka konkurrencë. Pyeti se si mund të zgjidhet kjo qështje me akte ligjore?

Myzejene Selmani – theksoj se Traktati i energjisë për Kosovën ka një rëndësi të veçantë dhe në këtë aspekt cili është roli i Traktatit për ndihmë Kosovës dhe pyeti se çka mund të

bëhet që Kosova të mos jetë e diskriminuar në veqanti nga Serbia sa i përket marrëveshjeve të energjisë. po ashtu kërkoj të informohet rreth modaliteteve të tregut si dhe komentet e Sekretariatit a janë përcjell në MEM?

Kaqusha Jashari – Pyeti e a ka ndonjë afat kur Kosova duhet të përmbushë kërkesat e parashtruara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë?

Sala Berisha – Shala – theksoj se Kosova do ti këtë parasysh detyrimet që dalin prej Traktatit të Athinës dhe do ti zbatoj ato. Sipas asaj që u tha nga përfaqësuesit e Sekretariatit, Agjencionet Rregullative caktojnë metodologjinë e tarifave e jo çmimet, si mund të kuptohet kjo?

Dirk Buschle (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë – SKE) – tha se kuptohet se ju i keni pranuar komentet e sekretariatit. Sekretariati e ka një funksion të trefishtë mbështetës, monitorues dhe zbatues dhe i ushtrojmë këto funksione në bazë të rregullt për të legjislacionet e të gjitha shteteve të cilat janë palë nënshkruese e Traktatit të energjisë. Njëra nga funksionet tjera të Sekretariatit gjithashtu është edhe zbatimi, dhe nëse diqka konkludojme se nuk është në përputhje me rregullat dhe parimet e Bashkimit Evropian atëherë ne duhet medoemos të fillojmë një procedurë e cila e bënë të qartë ndarjen e përgjegjësi, pra kur komentojmë në ligje është një mbështetje që e japim për shtetin nënshkrues, komentet tona nuk kanë qëllim të ndikojnë në ju, është përgjegjësi e Kuvendit që ti aprovojë ligjet dhe pasi ti aprovoni ne mund të themi se është apo nuk është në përputhje me rregullat e Bashkimit Evropian, me siguri se komentet tona në këtë fazë janë për shqyrtim nga ana juaj por nuk janë të detyrueshme dhe ju takon juve pra që të merrni vendimin për miratimin apo mosmiratimin e tyre. U përmend qështja e KOSST-it rasti kundër Republikës së Serbisë kjo ka një dimension i cili tejkalon marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy kompanive ndërmjet dy operatorëve të sistemit të transmissioinit. Ne jemi përpjekur në të kaluarën kemi bërë përpjekje të mëdha që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët të pranueshme për të dy kompanitë për dy operatorët, kjo nuk ka qenë e mundur pra e kemi mësuar këtë mësim përfundimisht dhe tani ndoshta nuk duhet të hyjë në shumë detale sepse ky është rast në vazhdim, por më lejoni të them se lidhur me këtë rast do të dëgjoni diqka shumë shumë shpejt. Sa i përket Modelit të Tregut në shtet përkatës ne mendoj se kemi krijuar një barazpeshë të saktë e cila vlen për të gjitha shtet në Evropë ndoshta edhe në botë, pavarësisht nëse është në Kosovë, Francë apo në SHBA nuk ka edhe ndonjë dallim aq të madh pra është dallimi ndërmjet besimit për një treg të bazuar në konkurrencë, ne besojmë se konkurrenca vet do ti reduktojë çmimet dhe ta ngrisë transparencën, mendoj se vendimet duhet tu lihen lojtarëve në treg duhet ti lihen kompanive pjesëmarrëse në treg të cilat marrin vendimet më racionale, pra kjo është njëra nga ideologjitë, njëra nga ideologjitë është që konkurrenca është rregullatori përfundimtar edhe më i mirë i tregut. Ndërsa nga ana tjetër ajo që u përshkrua këtu është mungesa e gjenerimit në Kosovë pra është siguria e furnizimit megjithëse dëshirojmë të kemi një treg konkurrenues duhet të sigurojmë se duhet të ketë energji elektrike, nuk i takon Sekretarisë që të marrë një anë apo një anë tjetër neve nuk na takon ta avokojmë p.sh. ideologjinë e konkurrencës si të tilla. Ajo çka duhet të themi është si të gjindet një barazpeshë ndërmjet konkurrencës si rregullator i tregut nga njëra anë, pra në këtë kuptim ne nuk kemi komentuar në modelin e tregut të propozuar ajo qka kemi komentuar ne

është në legjislacion në ligjet të cilat janë para Kuvendit. Këshilla jonë ka qenë që të mos përfshihet modeli i tregut si i tillë në legjislacion. Legjislacioni përcakton kornizën në bazë të të cilës lojtarët e tregut pastaj mund të veprojnë. Ne mendojmë se modeli i tregut nuk duhet të shkruhet në legjislacion se pastaj mund të thmei se është kundër konkurrencës apo ndonjë dispozite tjetër të traktatit. Kjo është arsyeja ajo çka ne jemi munduar të bëjmë në komentet tona sigurisht se të gjithë jemi në dijeni të këmbimit që duhet të bëhet apo të zgjedhjes që duhet të bëhet ndërmjet sigurisë së furnizimit nga njëra anë që është me rëndësi jetike për Kosovën dhe nga ana tjetër të sigurojmë që mënyra sesi bëhet kjo të mos e bllokojë tregun për një periudhë shumë shumë të gjatë pra jemi munduar të gjejmë një zgjidhje të ndërmjetme dhe duhet të sigurojmë që energjia elektrike apo furnizimi me energjinë elektrike në të njëjten kohë pra nëse e bëjmë këtë mund të sakrifikohemi më shumë sesa ja vlen që të sakrifikohet. Ne nuk jemi shprehur në këtë qështje specifikisht mirëpo ajo çka ne jemi mundu të bëjmë dhe ajo qfar mendojmë se është e rëndësishme është se duhet ti fuqizojmë autoritetet vendore ato autoritete shtetërore pra të sigurojmë që të ketë kontrollë dhe rregulla strikte në Kosovë, pra është Autoriteti Rregullator edhe Komisioni i Konkurrencës. Këto dy organe duhet të jenë vija e parë e mbrojtjes të sigurojnë që të ketë një balansë të mirë ndërmjet sigurisë së furnizimit nga njëra anë edhe konkurrencës nga ana tjetër dhe vetëm nëse e shohim se kjo shkon gabimisht dhe atëherë nuk i marim rolet seriozisht apo këto dy organe nuk i kanë mjetet apo kapacitetet për të vepruar atëher do të dhonim se do të ketë diçka për të rishqyrtuar në këtë aspekt. Ne ktu jemi për të siguruar që korniza të jetë në rregull dhe jo për të këshilluar lidhur me atë se cili model i tregut është më i saktë, ndoshta duhet ta shikojmë atë më pas mirpo vetëm pasi që legjislacioni të kalojë edhe të monitorohet në kuadër të Kosovës. Për këtë arsye kemi dhënë theks të veçantë në komentet tona që të bëhet kontrolla dhe balansa procedurat e rishikimit të jenë të mirfillta dhe të jenë funksionale. Një pyetje që u bë lidhur me subvencionimin e importimit të energjisë elektrike se kjo do të eliminohet apo jo pra blerja e energjisë elektrike, kjo është një qështje shqetësuese dhe është një qështje që ndërlidhet përsëri me kornizën. Njëra nga shqetësimet e Sekretarisë është se shteti juaj nuk ka legjislacion për ndihmën shtetërore, nuk e di a është ky komision që e ka mandatin të punojë për një ligj për ndihmën shtetërore dhe është një ligj që duhet të punohet shumë shpejt dhe afati i fundit ka qenë në vitin 2006 jemi katër vite që është tejkaluar afati pra nuk ka proceduar apo institucion i cili mund të shikojë nëse këto institucione janë në përputhje me Traktatin, Sekretariati e shikon vetëm në kuadër të rolit të saj të dytë pasi të miratohen ligjet. Ajo çfarë ne duam të bëjmë te ju këshillojmë të nxirret një ligj për ndihmën shtetërore dhe një agjenci për ndihmën shtetërore e cila i mbikëqyr të gjitha subvencionet të cilat jipen nga shteti, dhe agjenci kjo e cila në qdo rast i shqyrton nëse subvencionet janë bërë në mënyrë transparente dhe në mënyrë të rregullt, pre vetën nëse e shohim se kjo nuk funksionon do të ndërhyjmë.

Simon Uzunov (Sekretariati i Komunitetit të Energjisë – SKE) - Autoritetet Rregullatore sa i përket metodologjive të tarifave sigurisht që çfardo tarife që rregullohet duhet të përcaktohet në bazë të disa rregullave dhe metodologjive, pra nuk ka rëndësi metodologjia sesi zbatohet apo monitorohet apo nuk ka rëndësi sesi konfirmohet tarifa. Një autoritet mund të sjellë metodologjinë e një tjetër ta konfirmoj tarifen mirëpo nuk do të thotë që një Autoritet nuk mund të bëjë te dyat pra edhe ta nxjerri metodologjinë edhe

ta konfirmojë tarifen dhe kjo në fakt zakonisht bëhet në shumicën e shteteve. Ajo që është me rëndësi është transparenca e procesit, metodologjia duhet të publikohet diskutohet dhe të jetë e qartë për të gjithë se cila është metodologjia nga qfarë përbëhet ajo dhe qka do të thotë secila shifër në atë metodologji si zbatohet ajo shifer pra kjo është një gjë që ka të bëjë me transparencën. Një qështje tjetër është pasqyrimi i kostos së metodologjisë, metodologjia duhet ta pasqyrojë realitetin, duhet të pasqyrojë koston e kapitalit, koston e shpenzimeve dhe sigurisht koston e investimeve që është shumë vështirë për tu inkorporuar sepse ne pasyaj dueht të përkufizojmë se cilat investime duhet të pasqyrohen, nuk e përmenda koston e humbjeve por është kostoja e shpenzimeve, të gjitha investimet janë të rëndësishme dhe kjo është një qështje kyqe për hyrje në treg, përshkak se tregu në vetvete është i vetmjaftueshëm ose tenton që të jetë i vetmjaftueshëm dhe ata të cilët hyjnë në treg duhet të qëndrojnë në treg dhe kjo është arsyeja pse i definojnë qmimet dhe sinjalet e qmimeve që përfshijnë qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tyre, në tarifen e rregulluar nuk e kanë këtë mekanizëm për vet rregullim për qëndrueshmëri, sigurisht se tarifatat duhet të marrin parasysh qëndrueshmërinë dhe kjo është arsyeja kryesore pse ballafaqohemi me fenomenin ku ka diferenca ndërmjet tarifave në këtë rajon dhe qmimeve të tregut dhe efekti i saj është që vazhdimisht ka sinjale të gabueshme të qmimeve të energjisë elektrike pra të tarifave. Tarifatat janë vazhdimisht të gabuara përshkak se askush nuk ka treguar se ekziston qëndrueshmëria e tregut, sigurisht se tregu mund të devijojë gjithashtu mirëpo një treg likuid i cili aplikon konkurrencën, por tani qfar të bëjmë në një treg si është rasti i Kosovës i cili është i vështirë për konkurrencën. Ajo qfar duhet të bëjmë është që duhet të ngrisin transparençën në nivelin më të lartë përshkak se vetëm në këtë mënyrë mund të përcillen efektet e forta të konkurrencës edhe të përfshihen kostot e larta në furnizimin publik në mënyrë që të kemi furnizim me energji elektrike përshkak se pa kte nuk ka treg dhe nuk ka konkurrencë, prandaj duhet të bëjmë një kompromis sa i përket politikave, të kemi transparençë në pjesën e rregulluar edhe paralelisht të rregullohet pjesa konkurrese e tregut pra të bëhet paralelisht rregullimi i këtyre dy fushave, nga njëra anë të rregullohet pjesa që është publike ndërsa nga ana tjetër të rregullohet pjesa konkurrese. Modeli i tregut gjithashtu mund të bëhet në disa mënyra, ligji dmth nuk imiton modelin e tregut, ligji në fakt i vendos kornizën e tregut dhe sjell detyrimet dhe të drejtat e pjesëmarrësve të tregut, sesi do të vijnë këto efekte dhe se cili është zotimi minimal dhe efekti maksimal që pritet, mënyra sesi do të funksionojë kjo është qështje që duhet të studjohet dhe si do të jetë realiteti pra është diqka që nuk i përket aq shumë ligjit, dokumenti i tregut është dokument shumë më detal sesa ligji, askush në fakt nuk është duke kërkuar nga askush të përcaktohet një gjë në ligj, do të ishte shumë gabim në qoftë se mundohemi që ti zbatojmë të gjitha aspektet e modelit të tregut në ligj nuk është e nevojshme nuk kërkohet, pra vetëm efektet e tregut që janë të nevojshme të pasqyrohen në ligj, mirëpo këto efekte janë shumë të rëndësishme, këto parakushte janë shumë të rëndësishme edhe këto parakushte duhet medoemos të definohen edhe në ligj, ne nuk duhet thjesht ta braktisim idenë e tregut përshkak se për momentin mundësia është shumë e vogël mendojmë se platforma për krijimin e tregut duhet të ekzistojë në ligj përshkak se e kemi nënshkruar traktatin edhe e kemi detyrimin ndërkombëtar dhe së dyti përshkak se dëshironi të kemi një strukturë legjislativë. Po flas për përfaqësuesit, të gjithë duhet së bashku të punojmë për të tejkaluar këto pengesa dhe për të implementuar parimet e përbashkëta të rregullave konkurrese për zgjerimin e tregut dhe integrimin në tregun Evropian në të ardhmen, mirëpo ne duhet të mbijetojmë

në këtë kohë dhe kjo është arsyeja për shkak të sigurisë së furnizimit nuk kemi insistuar në konkurrencë që është në fakt jashtë realitetit për momentin dhe nuk mund të aplikohet. Ne kemi insistuar dhe kemi përgatitur komentet që ta bëjmë sistemin rregullativ të brendshëm.

Pas debatit Komisioni nxori këtë:

Konkluzion

Komisioni do të këtë parasysh komentet dhe këshillat nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë – SKE, për Pakon e projektligjeve të energjisë.

4. Të ndryshme

Çështje vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia e mbështetjes së Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Myzejene Selmani